

KONTRATE SHIT-BLERJE KUOTE

Sot më datë **21 / 05 / 2020**, në Tiranë, palët nënshkruese si më poshtë bien dakord për të lidhur këtë kontratë për shitblerje kuotash të kapitalit të shoqërisë "Hua Elektronike Investimi" sh.p.k:

Z. **Endri Ikonomi**, i biri i Rudit, shtetas shqiptar me numër personal H60228160A, lindur më 28/02/1976 në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me numër 033138998, banues në Rr. "Nikolla Tupe", Pall.6, Shk.2, Ap.12, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në vijim referuar "**SHITËSI**".

Z. **Endrit Hajredini**, i biri i Lulzimit, shtetas shqiptar me numër personal I30104043R, lindur më 04/01/1983 në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me numër 030863947, banues në Rr. "Astrit Balluku", Nr.13, Ap.1, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në vijim referuar "**BLERËSI**".

Shoqëria "**Hua Elektronike Investimi**" shpk, person juridik me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit Shqiptar, regjistruar në regjistrin tregtar më datë 29/06/2019 dhe me Numër Unik Identifikimi (NUIS) **L91828003D** dhe seli në adresën Rruga "Astrit Sulejman Balluku", Nr.13, H.22, Ap.2, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga administratori z. Endri Ikonomi, në vijim referuar "**SHOQËRIA**".

MEQËNËSE:

- A. Shitësi** deklaron se është ortak i Shoqërisë dhe zotëron **1** (një) **kuotë** të saj e cila përfaqëson **30%** (tridhjetë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë me vlerë **45,000** (dyzet e pesë mijë) **LEKË** dhe se kjo kuotë deri në datën e lidhjes së kësaj kontrate është shlyer pjesërisht prej shitësit në vlerën **45,000** (dyzet e pesë mijë) **LEKË**;
- B. Blerësi** deklaron se ka shprehur vullnetin e tij të lirë e të plotë për të blerë kuotën e shitësit dhe shitësi deklaron se ka shprehur vullnetin e tij të plotë e të lirë për t'i kaluar kuotën e tij blerësit nëpërmjet shitblerjes;
- C.** Në përputhje me Statutin e Shoqërisë si dhe dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), më datën 20/04/2020 është mbajtur mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë, në të cilën është miratuar **vendimi 8/2020** për kalimin nga shitësi tek blerësi i kuotës së shitësit që përfaqëson **30%** të kapitalit të regjistruar, me anë të shitblerjes;

Palët e mësipërme, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, bien dakord, si më poshtë vijon:



Neni 1

1.1 Objekt i kësaj Kontrate është shitblerja e **1** (një) **kuote** të Shoqërisë, që përfaqëson **30%** (tridhjetë përqind) të **kapitalit** të regjistruar të saj me vlerë **45,000** (dyzet e pesë mijë) **LEKË**, pronësia e të cilës vërtetohet në bazë të ekstraktit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, nga shitësi z. Endri Ikonomi, në favor të blerësit z. Endrit Hajredini, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

Neni 2

2.1 Palët kanë rënë dakord që çmimi i shitblerjes së kuotës së shitësit sipas kësaj kontrate është **45,000** (dyzet e pesë mijë) **LEKË**.

2.2 Ky çmim është likuiduar nga blerësi dhe shitësi deklaron se e ka marrë atë dhe nuk ka asnjë pretendim në lidhje me pagesën e tij nga Blerësi.



Neni 3

3.1 Me shitjen e kësaj kuote, sipas kësaj kontrate, shitësi humbet pronësinë mbi këtë kuotë dhe blerësi bëhet pronar i kësaj kuote me të drejta të plota si dhe merr përsipër përmbushje e çdo detyrimi që buron prej saj në favor të Shoqërisë.

Neni 4

4.1 Shitësi deklaron se është pronar me të drejta të plota mbi kuotën që i transferon blerësit e cila është e lirë nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë; nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e saj apo që t'u ketë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi të deri në datën e sotme që të mund të jetë shkak për cënimin e kontratës apo titullin e pronësisë së blerësit mbi to.

Neni 5


5.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.

5.2 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontratë, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5.3 Dokumentet bashkëlidhur dhe pjesë integrale e kësaj kontrate janë vendimi 8/2020 i datës 20/04/2020 i Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "Hua Elektronike Investimi" sh.p.k dhe ekstrakti me vulë elektornike i gjeneruar nga e-Albania i datës 21/05/2020.


Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) kopje me të njejtën vlerë ligjore nga 1 (një) kopje për Shitësin dhe Blerësin dhe 1 (një) kopje për Shoqërinë. Palët pasi e lexuan dhe e gjetën në përputhje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë e nënshkruajnë këtë kontratë.

PALËT KONTRAKTORE


SHITËSI


Endri Ikonomi


BLERËSI



Endrit Hajredini



"Hua Elektronike Investimi" shpk


Endri Ikonomi
(Përfaqësuesi ligjor)